

20091142169

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR HYRJE NË BORXH TË**  
**REPUBLIKES SË MAQEDONISE TE BANKA EVROPIANE PËR RINDERTIM DHE**  
**ZHVILLIM, SIPAS MARREVESHJES PËR KREDI PËR PROJEKTIN PËR**  
**PERPARIMIN E AVIACIONIT CIVIL AJROR**

Neni 1

Në Ligjin për hyrje në borxh të Republikës së Maqedonise me kredi të Banka Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim, sipas marreveshjes për kredi për Projektin për parimin e aviacionit civil ajror ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonise" numer (61/2002), neni 4 fshihet.

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si vijon:

“Kredine nga neni 1 të këtij ligji e paguan shoqata aksionare me një aksionar, shteti-dhenes i sherbimeve të navigacionit ajror, si trashagues juridik i drejtorise së aviacionit civil ajror nga të ardhurat personale dhe të tjera, në afate dhe kushte të verifikuara në Marreveshje për kredi për Projektin për perparimin e aviacionit civil ajror dhe shfrytezuesin e infrastruktures së aeroportit.”

Neni 3

Neni 7 fshihet.

Neni 4

Lartesine e pjeses së kredise sipas baze së Marreveshjes për kredi për Projektin për perparimin e aviacionit civil ajror dhe menyren e pageses së tyre nga ana e shoqates aksionare me një aksionar, shteti - dhenes i sherbimeve të navigacionit ajror, si dhe lartesine e pjeses nga kredia dhe menyren e pageses së tyre, të cilen shfrytezuesi i infrastruktures së aeroportit është i obliguar t’ia transferoje shoqates aksionare me një aksionar, shteti-dhenes i sherbimeve të navigacionit ajror, i percakton Qeveria e Republikës së Maqedonise, na afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Shoqata aksionare me një aksionar, shteti - dhenes i sherbimeve të navigacionit ajror, nenshkruan marreveshje me Ministrinë e Financave për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve që dalin nga Marreveshja për kredi për Projektin për perparimin e aviacionit civil ajror.

Neni 6

Ky Ligj hyn në fuqi ditën vijuese nga dita e shpalljes në „Gazeten zyrtare të Republikës së Maqedonise“.